



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, të enjten e shkuar, më 27 mars, dëshmitari i 125-të i thirrur nga Prokuroria dha dëshmi përmes videolidhjes dhe me masa mbrojtëse. Në marrjen e vendimit për miratimin e kërkesës për dëshmi përmes videolidhjes, gjykatësit morën parasysh se, në rastet kur për arsye shëndeti dhe/ose sigurie dëshmitari nuk mund të vijë në sallën e gjyqit, kjo përbën arsye të mjaftueshme për miratimin e dëshmisë përmes videolidhjes.

Gjykatësit gjithashtu vunë në dukje se dëshmitari do të pyetej në të njëjtat kushte si në sallën e gjyqit, dhe se gjykatësit, të akuzuarit dhe palët do të ishin në gjendje ta shihnin dhe dëgjonin dëshmitarin kur të jepte dëshmi në kohë reale dhe do të kishin mundësi t'i bënin pyetje. Ky dëshmitar e përfundoi dëshminë të enjten e shkuar.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, të martën, 1 prill, u mbajt një seancë gjyqësore e shkurtër, ku u njoftua se dëshmitari që pritej të jepte dëshmi nuk mund të paraqitej. Më pas, Prokuroria informoi se do të kërkonte që dëshmia e dëshmitarit të pranohej si provë me shkrim.

Prokuroria nuk pritet të thërrasë dëshmitarë të tjerë në sallën e gjyqit për këtë çështje gjyqësore dhe në të shkuarën ka njoftuar se planifikon ta mbyllë paraqitjen e provave të veta deri më 15 prill.

Një konferencë mbi ecurinë e çështjes është caktuar për datën 23 prill, për të diskutuar hapat e ardhshëm në këtë çështje.





Sipas Rregullores, pasi Prokuroria mbyll paraqitjen e provave të veta, Mbrojtja mund të dorëzojë mocion për rrëzimin e ndonjë akuze ose të gjitha akuzave.

Në varësi të këtyre mocioneve dhe vendimeve të Trupit Gjykes në lidhje me to, pas kësaj, mbrojtësi i viktimave do të ketë mundësi të paraqesë provat e veta.

Ka mbi 150 viktima pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor, përfshirë viktima të kombësive të ndryshme.

Pas kësaj, secili nga ekipet e mbrojtjes do të ketë mundësinë që, nëse dëshiron, të paraqesë prova dhe të thërrasë dëshmitarë në mbështetje të tyre.

Deri më tani, në gjykimin *Thaçi dhe të tjerë*, kanë dhënë dëshmi 125 dëshmitarë, ose në sallën e gjyqit, ose përmes videolidhjes.

Gjithashtu, deri tani në këtë gjykim, 117 dëshmitarëve u janë pranuar dëshmitë vetëm me shkrim.

Shtatëdhjetë e gjashtë prej këtyre dëshmimeve me shkrim u pranuan sipas rregullës 153, çka do të thotë se dëshmia nuk lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e pretenduar të të akuzuarve në këtë çështje.

Dyzet e një prej këtyre dëshmimeve me shkrim u pranuan sipas rregullës 155, kur dëshmitari nuk është i disponueshëm, për shembull, kur ka vdekur ose kur mosdhënia e dëshmisë nga personi është ndikuar thelbësisht nga ndërhyrje të palejueshme, ndër të cilat kërcënime, frikësim, lëndim, ofrim parash ose shtrëngim.

Në të njëjtën çështje, më 1 prill, Trupi Gjykes vendosi lidhur me Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Pashtrikut, disa prej të cilëve i pranoi si prova, ndërkohë që refuzoi pranimin e materialeve të tjera të kërkuara prej Prokurorisë. Në të njëjtën ditë, Trupi Gjykes pranoi si prova një intervistë me median

2





dhe ballinat e tre librave, që kishin të bënin me autenticitetin e një vëllimi që ishte paraqitur më parë për t'u pranuar si provë.

Më 27 mars dhe 1 prill, Prokuroria dorëzoi versionet me më pak redaktime të tre transkripteve të gjykimit lidhur me dëshmitë e tre dëshmitarëve në seancat e shkurtit 2025. Këto parashtrime lidhen me urdhrin e Trupit Gjykses të 7 nëntorit 2023 mbi parimin e procesit publik, që u kërkon palëve të rishikojnë dëshmitë e dhëna në seanca private dhe të propozojnë transkripte me më pak redaktime brenda afateve të caktuara nga Gjykata. Kjo bëhet për të siguruar që sa më shumë informacion të bëhet publik, por njëkohësisht të mbrohen dëshmitarët dhe viktimat.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Paneli i Gjykatës së Apelit caktoi seancën e apelit për 15 dhe 16 maj. Sipas urdhrin për caktimin e datës, në seancë do të përfshihen parashtrime gojore nga Mbrojtja, Prokuroria dhe mbrojtësi i viktimave.

Në të njëjtën çështje, më 28 mars, Paneli i Apelit rrëzoi një mocion të Mbrojtjes me të cilin kërkonte leje për të thirrur një dëshmitar dhe për të pranuar si prova transkripte, shënime dhe intervista lidhur me dëshminë e dëshmitarit në çështje gjyqësore të tjera. Në vendimin për rrëzimin e kërkesës, Paneli i Apelit shpjegoi me hollësi pse gjykatësit vendosën se dëshmia e dëshmitarit nuk do të kishte ndikuar në verdiktin e dhënë. Gjithashtu, gjykatësit vërejtën se Mbrojtja nuk i paraqiti Panelit të Apelit asnjë deklaratë lidhur me përmbajtjen e dëshmisë së pritshme të dëshmitarit, sikurse kërkohet në Rregullore.

